


REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 3046 Rep.

Nr. 1193 Kol.



KONTRATE PER SHITJEN E AKSIONEVE

Ne Tirane, sot, me 18.04.2006, perpara meje noterit te Dhomes se Notereve Tirane, u paraqiten palet e meposhtme te cilet me deklaruan se duan te lidhin kete Kontrate per Shitjen e Aksioneve (me poshte e quajtur "Kontrata"):

- **Z. Gjovalin Preçi**, shtetas shqiptar, lindur me 10.06.1962 ne Shkoder, Shqiperi, banues ne Tirane, mbajtes i pasaportes me numer 0012379, zoterues i 4.04% te kapitalit themeltar te shoqerise ALB SIGURACION SHA (e barazvlefshme me 10.000 aksione), nje shoqeri anonime, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar Shqiptar me vendimin nr. 30756, date 09.01.2004 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor, Tirane (me poshte i quajtur "Shitesi");

Dhe

- **Z. Zef Preçi**, shtetas shqiptar, lindur ne Shkoder, me 05.03.1958, mbajtes i pasaportes nr. 0013676, banues ne Tirane (me poshte i quajtur "Bleresi");

MEQENESE

- A. Shitesi zoteron 4.04% te kapitalit themeltar te Alb Siguracion SHA (e barazvlefshme me 10.000 aksione), nje shoqeri anonime, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar Shqiptar me vendimin nr. 30756, date 09.01.2004 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor, Tirane (me poshte e quajtur "Shoqeria"), me kapital 247.345.000 Leke, i ndare ne 247.345 aksione me vlere nominale prej 1.000 Leke secili;
- B. Bleresi deshiron te bleje 4.04% te kapitalit themeltar te Shoqerise (e barazvlefshme me 10.000 aksione) te zoteruar nga Shitesi ne Shoqeri;

C. Shitesi deshiron t'i shese Bleresit 4.04% te kapitalit themeltar te Shoqerise (e barazvlefshme me 10.000 aksione) te zoteruar prej tij ne Shoqeri dhe sipas Statutit te Shoqerise ky transferim kuotash eshte miratuar me vendimin date 15 prill 2006 te Asamblese se Aksionareve te Shoqerise.

Duke patur parasysh sa me lart palet bien dakort per sa vijon:

NENI 1

SHITJA DHE BLERJA E PJESEVE TE KAPITALIT

1.1 Shitesi i shet Bleresit dhe Bleresi blen nga Shitesi sipas kushteve te parashikuara ne kete Kontrate, 4.04% kapitalit themeltar te zoteruar nga ky i fundit ne Shoqeri (e barazvlefshme me 10.000 aksione), kundrejt çmimit prej 10.000.000 Leke (dhjete milione Leke), qe konsiston ne vleren e tyre nominale, me poshte i quajtur "Çmimi i Shitjes".

NENI 2

ÇMIMI I SHITJES DHE MENYRA E PAGESES

2.1 Bleresi i ka paguar ~~me para ne dore~~ Shitesit Çmimin e Shitjes ne ditën e lidhjes se kesaj Kontrate, fakt i cili vertetohet plotesisht nepermjet nenshkrimit te kesaj Kontrate.

2.2 Te gjitha detyrimet tatimore, duke perfshire tatimin mbi te ardhurat personale, te cilat rrjedhin nga transferimi i kuotave sipas kesaj Kontrate dhe qe mblidhen sipas legjislacionit shqiptar, do te paguhen nga ana e Shitesit. Bleresi pranon te paguaje te gjitha taksat e pulles, dokumenteve, ose regjistrimit, sot ose ne te ardhmen, qe rrjedhin nga çdo pagese per hartimin, dergimin ose regjistrimin ne lidhje me kete Kontrate.

2.3 Me pagimin e Çmimit te Shitjes se siperpermendur, Bleresi menjehere fiton pronesine mbi 4.04% te kapitalit themeltar te Shoqerise (e barazvlefshme me 10.000 aksione) dhe Shitesi zhvishet nga çdo e drejte pronesie, dividenti dhe nga te drejtat ne administrimin e Shoqerise, si dhe nga çdo e drejte tjeter qe rrjedh nga zoterimi i 4.04% te kapitalit themeltar te Shoqerise (e barazvlefshme me 10.000 aksione).



NENI 3

DEKLARIME DHE GARANCI

3.1 Shitesi deklaron dhe garanton se: (i) Eshte zoteruesi i 4.04% te kapitalit themltar te Shoqerise [e barazvlefshme me 10.000 aksione] (ii) Pjeset e kapitalit jane nenshkruar teresisht dhe shlyer plotesisht nga Shitesi (iii) Pjeset e kapitalit qe do transferohen jane te lira nga çdo barre ose pretendim i te treteve (iv) Aksioneret e Shoqerise kane miratuar transferimin e 4.04% te kapitalit themeltar te Shoqerise, e cila eshte objekt i kesaj Kontrate per Shitje Aksionesh, me vendimin e Asamblese se Ortakeve date 15.04.2006 (v) Kjo Kontrate perben detyrim ligjor, te vlefshem, te detyrueshem dhe te pashmangshem per Shitesin.

3.2 Bleresi deklaron dhe garanton se: (i) Kjo Kontrate eshte nenshkruar rregullisht dhe perben nje detyrim te ligjshem dhe te ekzekutueshem ndaj Bleresit ne perputhje me kushtet e parashikuara ne to.

NENI 4

TE NDRYSHME

4.1 Kjo Kontrate pergatitet dhe nenshkruhet ne kater kopje ne gjuhen shqipe dhe ky akt perben te gjithë marreveshjen e arritur midis paleve, premtimet, deklarimet, garancite ne lidhje me objektin e kesaj Kontrate. Asnje ndryshim i kesaj Kontrate nuk do te jete i vlefshem nese nuk behet me shkrim dhe nenshkruhet rregullisht nga secila pale.

NENI 5

LIGJI I ZBATUESHEM DHE ZGJIDHJA E MOSMARRVESHJEVE

5.1 Per çeshtjet te cilat nuk jane parashikuar ne kete Kontrate apo qe mund te rrjedhin prej saj do te zbatohet legjislacioni perkates ne fuqi ne Republiken e Shqiperise, i cili eshte ligji i zbatueshem per kete Kontrate.

5.2 Çdo mosmarrveshje qe mund te linde midis paleve te kesaj Kontrate ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e kesaj Kontrate, nese nuk zgjidhet ne mirekuptim mes vete paleve, do te



zgjidhet nga Gjykata e Shkalles se Pare Tirane, vendimet e se ciles jane te ankimueshme sipas dispozitave te Kodit te Procedures Civile te Republikes se Shqiperise.

Une Noteri, e lexoj tekstin e ketij akti me ze te larte dhe te kuptueshem paleve, Z. Gjovalin Preçi dhe Z. Zef Preçi te cilet pasi me deklaruan se e kuptuan tekstin e ketij akti i cili eshte ne perputhje te plote me theniet dhe vullnetin e tyre, e nenshkruajne ate rregullisht ne pranine time, ne 3(tre) kopje dhe une Noteri vertetoj sa me siper sipas ligjit ne fuqi.


SHITESI

Gjovalin Preçi



BLERESI

Zef Preçi



NOTERI

